

## 1. NDËRHYRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E PARASË GJATË TREMUJORIT TË PARË TË VITIT 2013

**Tabelë 1:** Vëllimi i operacioneve të përkohshme të tregut të hapur (në milionë lekë\*).

| DATA       | R/REPO njëditore | R/REPO njëjavore | R/REPO njëmujore |
|------------|------------------|------------------|------------------|
| 03.01.2013 |                  | 12,290.00        | 1,900.00         |
| 10.01.2013 |                  | 10,940.00        | 1,800.00         |
| 11.01.2013 | 1,200.00         |                  |                  |
| 17.01.2013 | 700.00           | 15,620.00        | 2,410.00         |
| 18.01.2013 | 700.00           |                  |                  |
| 21.01.2013 | 1,370.00         |                  |                  |
| 22.01.2013 | 1,260.00         |                  |                  |
| 23.01.2013 | 1,800.00         |                  |                  |
| 24.01.2013 |                  | 18,040.00        | 2,670.00         |
| 31.01.2013 |                  | 10,470.00        | 2,000.00         |
| 07.02.2013 |                  | 8,410.00         | 1,800.00         |
| 14.02.2013 |                  | 9,000.00         | 1,700.00         |
| 21.02.2013 |                  | 13,100.00        | 2,500.00         |
| 28.02.2013 |                  | 8,130.00         | 1,700.00         |
| 07.03.2013 |                  | 7,050.00         | 1,800.00         |
| 15.03.2013 | 1,400.00         | 10,740.00        | 1,800.00         |
| 18.03.2013 | 2,000.00         |                  |                  |
| 19.03.2013 | 2,000.00         |                  |                  |
| 20.03.2013 | 2,000.00         |                  |                  |
| 21.03.2013 |                  | 17,400.00        | 3,000.00         |
| 28.03.2013 |                  | 13,940.00        | 2,000.00         |

Ndërhyrjet në tregun e parasë, gjatë tremujorit të parë të vitit 2013, përfshijnë operacione të tregut të hapur për injektim likuiditeti.

Sasia totale e likuiditetit të injektuar është rritur nga mesatarisht 16 miliardë lekë në fund të muajit dhjetor, në mesatarisht 16.93 miliardë lekë në tremujorin e parë të vitit 2013. **Likuiditeti mesatar i injektuar është rreth 26% më i ulët se 1 vit më parë, kur kjo vlerë ishte 22.8 mld lekë.**

Për injektimin e likuiditetit Banka e Shqipërisë përdori instrumentin e saj kryesor, marrëveshjen e anasjelltë të riblerjes me maturim njëjavor, mesatarisht 11.93 miliardë lekë në javë\*, shoqëruar njëkohësisht me marrëveshje të anasjelltë riblerje me maturim njëmujor, mesatarisht 2.08 miliardë lekë në javë\*.

Për periudhën 17 -23 janar 2013, që përkon me ditët e fundit te periudhës së mbajtjes së rezervës së detyrueshme, instrumenti njëditor është përdorur në 5 raste, mesatarisht për 1.17 miliardë lekë në ditë. Pas njoftimit për rihapje të ankandeve të obligacioneve 7-vjeçare, nga data 15 mars 2013 deri në ndërhyrjen javore të radhës, e cila përkonte edhe me ditën e fundit të punës për periudhën e mbajtjes së rezervës së detyruar, u zhvilluan 4 operacione injektuese njëditore, mesatarisht 1.85 miliardë lekë për ankand.

### 1.2 Përdorimi i instrumenteve mbështetëse

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2013, depozita njëditore u përdor në total në 35 raste, mesatarisht 1.39 miliardë lekë, gati 4.57 miliardë lekë më pak se në tremujorin e kaluar kur ky instrument është përdorur në 60 raste, duke regjistruar një mesatare për rreth 5.96 miliardë lekë.


Instrumenti i kredisë njëditore është përdorur në 8 raste, mesatarisht 1.47 miliardë lekë, kryesisht përqendruar në datat 10-23 janar 2013, që përkojnë me fundin e periudhës së mbajtjes së rezervës së detyruar. Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2012, ky instrument u përdor në 2 raste, mesatarisht 0.91 miliardë lekë.

Grafiku i mëposhtëm paraqet në mënyrë të përmblëdhur ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë për periudhën 2011-2013.

Grafik 1. Ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë, në periudhën 2011-2013 (me çmim blerjeje).

\* Shifrat janë të shprehura në vlerë nominale.


Mbi ndërhyrjet në tregun e parasë dhe në tregun valutor gjatë tremujorit të parë të vitit 2013



**2. NDËRHYRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E BRENDSHËM VALUTOR GJATË TREMUJORIT TË PARË TË VITIT 2013**

2.1 Veprime me bankat e nivelit të dytë

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2013, Banka e Shqipërisë nuk ka qenë e pranishme në tregun valutor.



## Mbi ndërhyrjet në tregun e parasë dhe në tregun valutor gjatë tremujorit të parë të vitit 2013

### 2.2 Veprime me institucione të tjera

Edhe gjatë këtij tremujori kanë vazhduar të lidhen kontratat *swap* të blerjes së valutës *spot* dhe shitjes në të ardhmen me afate maturimi 33 dhe 34 ditë midis Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave nxitur nga nevoja e menaxhimit të likuiditeteve të kësaj të fundit. Blerjet e valutës së BSh-së nga MF-ja gjatë kësaj periudhe, qenë në total 3,632.06 milionë lekë, shitjet 3,645.6 milionë lekë, ndërsa marrëveshjet e pamaturuara ishin 981.32 milionë.

Blerjet e valutës nga institucionet e huaja llogariten në 408.97 milionë lekë (Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim – IBRD dhe Agjencia Ndërkombëtare për Zhvillim – IDA).

| Institucioni financiar | Blerje të valutës<br>(në milionë lekë) | Shitje të valutës<br>(në milionë lekë) |
|------------------------|--|--|
| MINISTRIA E FINANCAVE  | 3,632.06                               | 3,645.6                                |
| TË TJERA (IDA, IBRD)   | 408.97                                 |  |